



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 1550 Prot.

Tiranë, më 11.02 2014

URDHËR
(Nr. 321 datë 11.02 2014)

**PËR PËRFUNDIMIN E PERIUDHËS KALIMTARE NË KRYERJEN E
FUNKSIONEVE TË DHËNA AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT, NGA
LIGJI NR.10 448, DATË 09.06.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës e Republikës të Shqipërisë, ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" pikat 1 e nenit 60 të ligjit Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", nenit 4 dhe pikës 2 të nenit 32 të Ligjit Nr. 10 448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit", Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe të V.K.M. Nr.47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit",

URDHËROJ:

1. Përfundimin e periudhës kalimtare në kryerjen e funksioneve Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të dhëna nga ligji nr. 10 448, datë 09.06.2011 "Për lejet e mjedisit".
2. Shqyrtimi dhe vlerësimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A dhe B do të realizohet vetëm nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
3. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Urdhëri, Urdhëri nr. 908, datë 14.10.2013 "Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të kërkesave për pajisje me Leje Mjedisore", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në fletore zyrtare.



Lefter KOKA

MINISTËR